

VENDIM

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 15 shkurt 2005 (dymije e pese), une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, A. COCO, mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi **Ylli XHAFERI**, i biri i Syzjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, Administrator i shoqerise "E&B " shpk. dhe :

KONSTATOVA

Se shtetasi Ylli Xhaferi, ka themeluar sipas aktit te themelimit dhe statutit te nenshkruar prej tij shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " E&B " shpk.. Selia e shoqerise eshte ne Tirane.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar 100 % nga ortaku i vetem Ylli Xhaferi. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 20 vjet.

Administrator e shoqerise eshte **Ylli Xhaferi**

Objekti i veprimtarise se shoqerise sipas statutit dhe aktit te themelimit eshte ne fushen e Import eksport me shumice dhe pakice te te gjitha artikujve ushqimore, industriale, materiale ndertimi, elektrike, elektronike. Tregtim te konfeksioneve, tekstile, kepuce, prodhime lekure. Tregtim me pakice te karburanteve, nenprodukteve te naftes, vajrave per mjetet e transportit, lubrifikante, lende djegese, vajguri , gaz te lenget. Tregtim te lendeve te para per prodhimin e mobilieve dhe elementeve te tyre. Prodhim te materiale te ndertimit, blloqeve te betonit. Tregtim te paisjeve hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe cdo artikulli tjeter per ndertim e mirmbajtje shtepish. Tregtim te artikujve shkollore, te sistemeve informatike. Tregtim te artikujve te kozmetikes, dentare, optike, higjino sanitare dhe paisje e vegla mjeksore te sherbimit human e veterinar. Tregtim te amballazheve te ndryshme. Transportit per vete dhe te tretet. Pasi shqyrtova kerkesen , aktin e themelimit dhe statutin e paraqitur nga kerkuesi konstatoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ", dhe Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993, " Per Regjistrin Tregtar ".

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " E&B " shpk.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar 100 % nga ortaku i vetem Ylli Xhaferi. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 20 vjet.

Administrator e shoqerise eshte **Ylli Xhaferi**.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ne fushen e :

Import eksport me shumice dhe pakice te te gjitha artikujve ushqimore, industriale, materiale ndertimi, elektrike, elektronike. Tregtim te konfeksioneve, tekstile, kepuce, prodhime lekure. Tregtim me pakice te karburanteve, nenprodukteve te naftes, vajrave per mjetet e transportit, lubrifikante, lende djegese, vajguri , gaz te lenget. Tregtim te lendeve te para per prodhimin e mobilieve dhe elementeve te tyre. Prodhim te materiale te ndertimit, blloqeve te betonit. Tregtim te paisjeve hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe cdo artikulli tjeter per ndertim e mirmbajtje shtepish. Tregtim te artikujve shkollore, te sistemeve informatike. Tregtim te artikujve te kozmetikes, dentare, optike, higjino sanitare dhe paisje e vegla mjeksore te sherbimit human e veterinar. Tregtim te amballazheve te ndryshme. Transportit per vete dhe te tretet. Tirane, me shkurt , 2005

GJYQTARE

Ariana Coco
AS

**SHOQERIA TREGTARE
me pergjegjesi të kufizuar
" E&B " shpk.**

AKT THEMELIMI



Ne Tirane, sot me daten 10.02.2005, (dymije e pese), une shtetasi :
Ylli XHAFERI, i biri i Syrjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane ,
shtetas shqiptar, Administrator i shoqerise "E&B " shpk., duke u bazuar ne :
Vullnetin tim të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private,
Ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
Ne ligjin 7638 date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare ",
Ne ligjin nr. 7667 date 28.01.1993, " Per regjistrin tregtar", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj
shoqerine tregtare, me ortak të vetem me pergjegjesi të kufizuar, " E&B " shpk , Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga une ortaku i vetem me emertimin " E&B " shpk, emer i cili do të
jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise " E&B " shpk eshte ne Tirane .

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës se
Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të ortakut te vetem, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur), seli, filiale,
agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të
tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare
private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindmije), formuar dhe nenshkruar nga
ortaku i vetem, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit.
Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesis mbi cdo lloj kapitali, mjete
xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me
kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqshuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të
shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si person
juridik.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të Ortakut të vetem, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Gjykatës kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në leke vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku i vetem dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është celur llogaria dhe terheqja e pjesëve të saj bëhet kur ceku Bankar është firmosur nga ortaku i vetem dhe Administratori i shoqërisë, në rastin kur ortaku i vetem cakton një administrator dhe vetem me firmën e ortakut të vetem, kur ky vete kryen njëkohësisht dhe detyrën e Administratorit të shoqërisë.

NENI 9

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaku i vetem, ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo teresisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë ortaku i vetem duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqëria dhe të tretet duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 10

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në fushën e :

Import eksport me shumicë dhe pakicë të të gjithë artikujve ushqimorë, industriale, materiale ndertimi, elektrike, elektronike. Tregtim të konfeksioneve, tekstile, kepuce, prodhime lekure. Tregtim me pakicë të karburanteve, nënprodukteve të naftës, vajrave për mjetet e transportit, lubrifikante, lende djegëse, vajguri, gaz të lenget. Tregtim të lendeve të para për prodhimin e mobilieve dhe elementeve të tyre. Prodhim të materialeve të ndertimit, blloqeve të betonit. Tregtim të paisjeve hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe çdo artikulli tjetër për ndertim e mirmbajtje shtëpish. Tregtim të artikujve shkollorë, të sistemeve informatike. Tregtim të artikujve të kozmetikës, dentare, optike, higjienë sanitare dhe paisje e vegla mjeksore të shërbimit human e veterinar. Tregtim të ambalazheve të ndryshme. Transportit për vete dhe të tretet.

NENI 11

Me vendim të ortakut të vetem, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërisë.

Me vendim të ortakut të vetem, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjetere tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.

NENI 13

Ortaku i vetem eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji " Per shoqerite tregtare " i njehe amblese se ortakeve qe jane krijuar me ortakeri. Ortaku i vetem mund t'ia delegoj kompetencat nje ose me shume administratorve të caktuar prej tij ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

NENI 14

Administrator i shoqerise " E & B " shpk., emerohet Z. Ylli Xhaferi.

NENI 15

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njehta juridike dhe ai eshte i vlefshem kur ne të gjithë faqet e tij eshte vene emri, mbiemri dhe firma orgjinale e ortakes themeluese dhe kur vertetimi i autenticitetit të nenshkrimtit eshte bere nga Noteri.

THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE
"E & B" SHPK

Ylli Xhaferi


SHOQERIA TREGTARE
me pergjegjesi të kufizuar
“ E&B ” shpk

STATUT

KREU I:

EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

NENI 1

Ne Tirane, sot me daten 10.02. 2005, (dymije e pese), nga Ortaku **Ylli XHAFFERI**, i biri i Syrjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane , shtetas shqiptar, Administrator i shoqerise “E&B “ shpk.

NENI 2

Shoqeria tregatre eshte vendase dhe quhet me emrin “ E&B ” shpk, emertim i cili do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 3

Selia Qendrore e shoqerise “ E&B ” shpk eshte ne Tirane .

NENI 4

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim të ortakut të vetem, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur), seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte **100.000 leke** (njeqindmije), formuar dhe nenshkruar nga ortakut i vetem, i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 kuote / 1000 leke, i depozituar sipas ligjit, ku nje kuote eshte e barabarte me nje vote vendimore.

Ortakut i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar Gjykates per njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është mbi 20 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të Ortakut të vetëm, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Gjykatës kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 8

Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në fushën e :
Import eksport me shumicë dhe pakicë të të gjithë artikujve ushqimorë, industrialë, materiale ndërtimi, elektrike, elektronike. Tregtim të konfeksioneve, tekstile, kepuce, prodhime lëkure. Tregtim me pakicë të karburanteve, nënprodukteve të naftës, vajrave për mjetet e transportit, lubrifikante, lende djegëse, vajguri, gaz të lenget. Tregtim të lendeve të para për prodhimin e mobilieve dhe elementeve të tyre. Prodhim të materialeve të ndërtimit, blloqeve të betonit. Tregtim të paisjeve hidrosanitare e termosanitare e termoizolues si dhe çdo artikulli tjetër për ndërtim e mirmbajtje shtëpish. Tregtim të artikujve shkollorë, të sistemeve informatike. Tregtim të artikujve të kozmetikës, dentare, optike, higjienë sanitare dhe paisjeve e vegla mjeksore të shërbimit human e veterinar. Tregtim të ambalazheve të ndryshme. Transportit për vetë dhe të tretet.

NENI 9

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e shpalljes së Vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate. Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi të jetë regjistruar dhe paisur me certifikatat përkatëse në Organin e Tatimit Taksave .

NENI 10

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nenligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektivit të veprimtarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

KREU II:

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria cel llogari bankare në leke vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku i vetëm dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në Bankat ku është celur llogaria dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur ceku Bankar është firmosur nga ortaku i vetëm dhe Administratori i shoqërisë, në rastin kur ortaku i vetëm cakton një administrator dhe vetëm me firmën e ortakës së vetëm, kur ky vetë kryen njëkohësisht dhe detyrën e Administratorit të shoqërisë.

NENI 12

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të

Ortaku i vetem ka të drejte të transferoj jashte territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo teresisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë.
Transferimet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vertetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë ortaku i vetem duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.
Shoqëria dhe të tjerë duhet të respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr ortaku i vetem, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës.

Me vendim të Ortakut të vetem ajo ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ja tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë ortakerisë ose personave juridikë, vendas apo të huaj mbi bazën e aktit noterial, duke ju cëduar atyre dhe të drejtën e qenies ortak në raport me pjesën e kuotave të kapitalit të tjetërsuar.

Cdo vendim i ortakes së vetem për ndryshimin e kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë Gjykatës kompetente që e ka njohur dhe regjistruar shoqërinë si person juridik.

KREU III :

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TË VETEM

NENI 14

Ortaku i vetem është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjithë kompetencat që ligji "Për shoqëritë Tregtare" i njeh asamblese së ortakeve që janë krijuar me ortakeri.

Ortaku i vetem mund t'ja delegojë kompetencat një ose me shumë Administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakerisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.

NENI 15

Me vendim të Ortakut të vetem shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortake të tjera, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit.

NENI 16

Ortaku i vetem i shoqërisë ka dhe këto të drejta dhe detyra kryesore :

Të marrë pjesë në drejtimin dhe administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

Të kërkojë dhe t'i japë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare dhe financiare të veprimtarisë së shoqërisë, si dhe të gjitha dokumentave të përpunuara nga shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të bilancit kontabel apo për çdo llogari të celur si dhe të asaj likuiduese dhe asaj rrjedhese.

Të marrë pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në çfarëdo forme apo sasi, sipas kontributit të dhënë prej tij.

Të kryejë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

Emeron dhe shkarkon në çdo kohë Administratorin e shoqërisë, cakton ekspertin kontabel të autorizuar. Ekspertin kontabel të autorizuar e ngarkon për përgatitjen dhe nxjerrjen e bilancit vjetor

ekonomiko financiar të aktivitetit të shoqërisë, të cilin ia paraqesin ortakjat mbi bazen e raportit me shkrim dhe pas shqyrtimit të tij, ortakju i vetëm ka dhe të drejtën e miratimit vendimor të këtij bilanci.

Nxjerrja e bilancit financiar vjetor mbi bazen e të dhënave të kontabilitetit, bëhet brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Ortakju i vetëm kryesisht si dhe Administratori i emëruar prej tij dhe kur ky i fundit është i paisur me prokurë, ushtrojnë dhe këto të drejta :

Mundësohen për të kryer të gjitha aktet dhe veprimet juridike që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj sic mund të jenë :

1. Të lidhin kontrata të ndryshme që kanë për objekt blerjen, shitjen, këmimin, marrjen me qera të pasurive të ndryshme (të luajtshme apo të paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridikë, vendas apo të huaj si dhe me shtetin dhe në rast të blerjes së pasurive të paluajtshme, të bëjnë dhe transkriptimin e pronësive së saj në favorin e tyre në Hipotekën e ZRPP, për të dokumentuar një rrethana të tillë dhe si shtesë të kapitalit në natyrë.
 2. Të kryejë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private dhe shtetërore, Bankat e çdo niveli etj. që kanë të bëjnë me Garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, sigurimeve, transportit (brenda dhe jashtë shtetit), për zhdoganimin e mallrave të importuara apo eksportuara, atë të plotësimit me korektësë të dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes në kohë të çdo detyrimi. Në rastet kur këto veprime juridike kryhen nga administratori i emëruar nga ortakju i vetëm ose personi që e përfaqëson atë mbi bazen e prokurës, këta në përfundim të realizimit të veprimit përkatës detyrohen që të njoftojnë menjëherë dhe t'i japin llogari ortakjtë të vetëm.
- Administratori ose përfaqësuesi me prokurë janë individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këto Statute dhe për dëmin e shkaktuar me faj, sipas rastit, ortakju i vetëm mund të ngrejë dhe të kërkojë ndaj tyre padi për shlyerjen e dëmit civil, duke përfshirë dhe të drejtën për të bërë kallxim për ndjekje penale në Prokurorinë e Juridiksionit tokësor ku ka selinë shoqëria.

NENI 17

Përfaqësimi i shoqërisë në marrëdhëniet me të tretet si brenda dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht i përket Administratorit, i cili është Ylli Xhaferi.

NENI 18

Ortakju i vetëm dhe administratori i shoqërisë, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqërisë, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhore dhe me zotësi të plote për të vepruar, duke lidhur kontrata sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi të miratuar me ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 dhe me ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 " Për sigurimet shoqërore " si dhe në përshatje me rregullat e brendshme të disiplinës teknike dhe të punës të caktuara nga vete punëdhësi.

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë, mbyllet me datën 31 Dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabel të shoqërisë, mbi bazen e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga ortakju i vetëm një ekspert kontabel i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të

ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut të vetem per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ai ka.

NENI 20

Nxjerrja e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bere me saktesi dhe duke respektuar të gjitha rregullat qe percaktohen ne Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, qe jane të detyrueshme per tu zbatuar nga cdo subjekt privat, qe ushtron veprimtari tregtare.

NENI 21

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku ivetem, ne të cilin ai jo vetem qe dokumenton miratimin e tij por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të metejshem të shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecante etj.

NENI 22

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakes se vetem të shoqerise.

NENI 23

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast ortaku ivetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

NENI 24

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrin Tregtar.

NENI 25

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

NENI 26

Cdo mosmarrveshje apo konflikt qe mund të lind gjate ushtrimit të veprimtarise se Shoqerise si rregull dhe pergjithesisht ortaku ivetem duhet ta zgjidh ne mirekuptim, ne të kunderten ceshtjen mund të beje objekt konflikti gjyqsor ne Gjykates e Shkalles se Pare Tirane.

NENI 27

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet udhezimeve plotesuese dhe të ligjshme të dhena nga ortaku i vetem si dhe legjislacioni ne fuqi.

NENI 28

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridik, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga une ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare " E&B " shpk, nenskruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen time orgjinale, autenticiteti i të cilave vertetohet nga Noteri.

THEMELUES I SHOQERISE
" E&B " shpk


Ylli Xhafëri



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1041 Rep.

Nr. - Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 10.02.2005 (dymije e pese), para meje Noteres Publike Majlinda LLeshi, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetesi me keto identitete

Ylli XHAFFERI, i biri i Syrjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane , shtetas shqiptar, Administrator i shoqerise "E&B " shpk.


Shtetasi eshte madhore dhe me zotesi të plote juridike per të vepruar i njohur personalisht prej meje Noteres ,

Me vullnetin e tij të lire e të plote ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, me cilesine e administratorit të shoqerise " E&B " shpk., kerkesen drejtuar Gjykates se Shkalles se pare Tirane, per regjistrimin si person juridik të kesaj shoqerie tregtare dhe pasi e lexoi ate e nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale të tij ne kete zyre dhe para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të kesaj kerkese si dhe autenticitetin e nenskrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.



NOTERE





DEGA TIRANA 1

Bulevardi 'Zhan d'Ark'

Tel:++355(0)4 266276/7/8

Fax:++355(0)4 266282

Tirane, me 11-02-2005

VERTETIM

Me te cilen vertetojme se **Z.YLLI XHAFERI** ka depozituar prane deges se BKT-se Tirana 1, shumen **100.000 (Njeqind mije) Leke** si kapital fillestar per krijimin e shoqerise "**E&B**" **SHPK**

E leshojme kete vertetim me kerkesen e vete klientit

DREJTORI
TIRANA SAN



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1042 Rep.

Nr. 150 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 10.02.2005 (dymije e pese), para meje Noteres Publike Majlinda Lleshi, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht shtetasi me keto identitete :

Ylli XHAFERI, i biri i Syrjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane , shtetasi shqiptar, Administrator i shoqerise "E&B " shpk.


Shtetasi eshte madhore dhe me zotesi të plote juridike per të vepruar.

Me vullnetin e tij të lire e të plote dhe të sinjerte ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, ne kater ekzemplare me permbajtje dhe vlera të njeja juridike, me cilesine e Ortakut te vetem të shoqerise " E&B " shpk, Aktin e Themelimit të perbere nga 15 nene dhe Statutin e kesaj shoqerie tregtare perbere nga 28 nene të dhe pasi i lexoi i nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen orgjinale të tij, ne kete zyre dhe para meje Noterit.

Une Noteri vertetoj rregullsin dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij Statuti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh Ligji nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.



NOTERE



32956

KERKESE

15 SHKURT 1995

Z. A. Cero

15. 02 2000

[Handwritten signature]



PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

KUES: Ylli XHAFERI, i biri i Syrjait i datelindjes 17.10.1956, lindur ne Skrapar dhe bashkëshorter, shtetas shqiptar, Administrator i shoqerise "E&B" shpk.

EKTI : Rregjistrimin si person juridik të shoqerise "E&B" shpk. .

A LIGJORE : Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe ligji 7667 date 1.1993 " Per regjistrin tregtar " .

**DREJTUAR:
GJYKATES SE SHKALES SE PARE**

TIRANE

I nderuar Kryetar !

shitetasi **Ylli Xhaferi**, administrator i Shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "E&B" shpk parashtroj se eshte krijuar shoqeria e mesiperme e themeluar nga:

Ortak i vetem i shoqerise Ylli Xhaferi

Administrator Z. Ylli Xhaferi

Kapitali 100.000 leke i zotuar dhe nenshkruar nga ortaku i vetem.

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Tirane

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise eshte mbi 20 vjet.

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj sipas aktit te themelimit dhe statutit të rruar nga ortaku i vetem.

Bashkelidhur me kete kerkese dergohen të noterizuara Akti i Themelimit, Statuti i shoqerise akte të tjera dokumentare, qe vertetojne kapitalin e shoqerise të nenshkruar.

Me besimin se kerkesa ime ligjore do të merret ne konsiderate dhe pranohet, ju faleminderit rekuptimin.

ADMINISTRATOR

[Handwritten signature]
Ylli Xhaferi

